

## Karta e-dytë e Apostollit Pavël mbë Korinthianëtë.

### Krye 1.

- 1 Pavli, apostoll i Jisu Krishtit me anë të dashurimit të Perëndisë, edhe vëllaj Timothe, mbë kishën'e Perëndisë që është ndë Korinthë, bashkë me gjithë shënjtorëtë që janë
- 2 ndëpër gjithë Ahainë; Hir qoftë mbë ju edhe paqtim nga Perëndia Ati ynë, edhe nga Zoti Jisu Krisht.
- 3 I-bekuarë *qoftë* Perëndia edhe Ati i Zotit t'ënë Jisu Krisht, Ati i përdëllimevet edhe
- 4 Perëndia i çdo ngushullimi, Qe na ngushillon mbë çdo shtrëngim t'ënë, që të muntmë të ngushullojm'ata që *gjëndenë* mbë çdo shtrëngim, me anë të *ati* ngushullimi që ngushullonemi *edhe neve* vetë nga Perëndia;
- 5 Sepse sikundrë tepëronjënë të-pësuarat'e Jisu Krishtit mbë ne, kështu me anë të Jisu
- 6 Krishtit tepëron edhe ngushullimi ynë. Edhe ndë kemi shtrëngime, kemi për ngushullimin' e për shpëtimnë t'uaj, qe punonetë me anë të durimit të gjithatyre të-pësuarave që pësojmë edhe ne; a ndë ngushullonemi, *ngushullonemi* për ngushullimin' e për shpëtiminë t'uaj; edhe shpresa jonë për ju *është*-e-pa-

- 7 tundurë. Sepse e dimë, se sikundrë jeni pjesëtarë mbë të-pësuarat, kështu *dotë jeni* edhe mbë ngushullimt.
- 8 Sepse s'duamë të mos dini, o vëllezër, për shtrëngiminë t'ënë që na gjajti nd' Asit, se vuajtmë jashtë masësë, përmbi fuqinë t'ënë, kaqë sa udëshpëruam' edhe për jetënë.
- 9 Po neve ndë vetëhet t'ënë kishimë marrë vendimn'e vdekjesë, që të mos kemi shpresë mbë vetëhenë t'ënë, po mbë Perëndinë që
- 10 ngjall të-vdekuritë; I-cili na shpëtoj prej një vdekjeje kaqë se-madhe, edhe na shpëton; mbë të-cilinë shprejmë, se edhe *prapë* dotë
- 11 *na* shpëtonjë, Kur të na ndihni edhe ju me të-luturëtë për ne, qe të bënetë të-falurë ndersë për neve prej shumë vetash për dhuratënë që *ud'ra* mbë ne me anë të shumë njerësve.
- 12 Sepse të-mburruritë t'anë është këta, dëshmimi i ndërgjegjesë s'anë, se me thjeshtësirë e me kthjellësirë Perëndie, e jo me dituri mishi, po me hir Perëndie, usuallmë ndë
- 13 *këtë* botë, edhe më tepërë te ju. Sepse nuk' u shkruajmë juve të-tjera, po ato që këndon, a edhe i njihni; edhe shprenj se edhe
- 14 gjer ndë funt dot'i njihni, Sikundrë edhe na keni njohurë gjer mbë një shkallë, se jemi mburrim mbë ju, sikundrë *edhe* juve mbë ne, ndë ditët të Zotit Jisu.
- 15 Edhe me këtë besim donja të vinja te ju

- më përpara, që të kishitë *një* hir të-dytë,  
 16 Edhe prej jush të-shkonja ndë Maqedhoni;  
 edhe përsëri nga Maqedhonia të vinja te ju,  
 edhe prej jush të përcilleshe për ndë Judhet.  
 17 Dyke menduarë pra këtë, vallë mos përdora  
 mëndje të-lehtë? apo sa mendonj, pas mi-  
 shit i mendonj, që të jetë mbë mua po po,  
 18 e jo jo? Po Perëndia është besëtar, se fjala  
 jonë që *ufol* mbë ju s'ubë po edhe jo.  
 19 Sepse i Bir'i Perëndisë Jisu Krisht, që u-  
 lëçit ndër ju me anë t'ënë, me anë t'ime edhe  
 te Silluanit edhe të Timotheut, s'ubë po edhe  
 20 jo, po ubë po mb'atë. Sepse gjithë të-zotua-  
 rat'e Perëndisë janë mb'atë po, edhe mb'atë  
 amin, për lavdi të Perëndisë me anë t'ënë.  
 21 Edhe ay qe na forcon neve bashkë me ju  
 mbë Krishtinë, e që na leu *me vaj*, është  
 22 Perëndia. I-cili edhe na vulosi, edhe na dha  
 kaparin'e Frymësë ndë zëmërat t'ona.  
 23 Edhe unë thërres për dëshimtar Perën-  
 dinë mbë shpirtinë t'im, se dyke kursyerë  
 24 juve s'erdha më ndë Korinthë; Jo se kemi  
 pushtet mbi besënë t'uaj, po se jemi bashkë-  
 punëtorë të gëzimit t'uaj; sepse qëndroni  
 ndë besët.

## Krye 2.

- 1 Edhe me vetëhenë t'ime vendosa këtë,  
 2 të mos vinj përsëri te ju me hidhërim. Sepse  
 unë ndë u hidhërofsha juve, e cili është ay

- që më gëzon, ndë mos është ay që hidhë-  
 3 ronetë prej meje? Edhe u shkrova juve këtë,  
 që, kur të vinj, të mos kem hidhërim nga  
 ata që duhej të kishnjam gëzim; dyke pa-  
 surë shpresë mbë gjithë ju, se gëzimi im  
 4 është i juve të-gjithëve. Sepse prej shumë  
 shtrëngimi e acarimi të zëmërsë u shkrova  
 juve me shumë lot, jo që të hidhëroneni, po  
 që të njihni dashurinë që kam me të-tepërë  
 mbë ju.  
 5 Edhe ndë ubë ndonjë ngajë hidhërimi,  
 s'më ka hidhëruarë mua vetëmë, po gjithë  
 ju gjer mbë një shkallë, që të mos u ngar-  
 6 konj juve të-gjithë. Mjaft është për të-këti-  
 llinë *njeri* ky qërtim që ubë prej më të-shu-  
 7 mëvet. Kaqë sa përkundrazi *duhetë* më te-  
 përrë t'a ndjeni *atë* edhe t'a ngushlloni, që  
 të mos përpihetë i-këtili *njeri* nga hidhëri-  
 8 mi i-tepërrë. Përandaj u lutem juve t'i dëf-  
 9 teni ati dashuri. Sepse përandaj edhe u  
 shkrova, që të njoh provënë t'uaj, ndë jini  
 10 të-dëgjuarshim mbë të-gjitha. Edhe ati që  
 t'i falni gjë, *j'a fal* edhe unë; sepse ndë kam  
 falur' unë gjë, kujdo që t'ja kem falurë, për  
 ju e kam bërë këtë, përpara Krishtit, që të  
 mos tepëronjë fuqia e Satanajt përmbi ne;  
 11 Sepse i dimë mendime'te ati.  
 12 Edhe kur erdha ndë Troadhë për të-lëçit-  
 ure ungjillin' e Krishtit, edhe m' uhap derë  
 për Zotinë, s'pata të-prëjturë ndë shpirt

t'im, sepse nukë gjeta Titonë vëllanë t'im;  
13 Po si u lashë shëndet atyre, dolla e *vajta* ndë Maqedhoni.

14 Po i falemi ndersë Perëndisë që na bën të dalëmë mundës kurdo mbë Krishtinë, edhe që çpërfaq mbë çdo vënt erën'e-mirë e  
15 të njohurit të ti me anë t'ënë. Sepse er' e-mirë e Krishtit jemi *neve* përpara Perëndisë mb'ata që shpëtonjënë edhe mb'ata që hum-  
16 basënë; Mbë këta *jemi* erë vdekjeje për vdekje, e mb'ata erë jete për jetë. Edhe për  
17 këto cili është' i-zoti? Sepse *neve* nuk'ë prishmë për kobim fjalën'e Perëndisë, sikundrë *bëjnë* të-shumëtë, po si prej zëmërrë sëkthjellëtë, po si prej Perëndie, përpara Perëndisë, flasmë mbë Krishtinë.

## Krye 3.

1 Zëmë përsëri të ndorëzojmë vetëhenë t'ënë? apo mos kemi nevojë, si ca *veta*, për kartëra ndorëzimi mbë ju, a për kartëra ndorëzimi prej jush? Ju jeni karta jonë shkruarë brënda ndë zëmërrat t'ona, që njihet'e këndonetë nga gjithë njerëzitë; Edhe çpërfaqeni se jeni një kart'e Krishtit, e-bërë me anë të shërbimit t'ënë, që është shkruarë jo me mellan, po me Frymën'e Perëndisë së-gjallë, jo mbë dërrasa të-gurta, po mbë dërrasa të-mishta të zëmërrësë.

4 Edhe të-këfillë të-besuarë kemi mbë Pe-

5 rëndinë me anë të Krishtit; Jo se jemi të-zotë prej vetiu të kupëtojmë ndonjë gjë, posi prej vetëhesë s'onë, po trimëria jonë  
6 *është* nga Perëndia; I-cili edhe na bëri të-zotë të jemi shërbëtorë të dhjatës'së-re, jo të shkronjësesë, po të frymësë; sepse shkronja vret, po fryma ep jetë.

7 Po ndë qoftë se shërbesa e vdekjesë, që është shkruarë me shkronja ndë gur, ubë e-lavduruarshime, kaqë sa të bijt'e Israilit s' muntninë të vështroninë me sy faqen'e Moisiut nga lavdia e faqes' s'ati, që ishte për  
8 të prishurë. Qysh nukë dotë jetë më shumë  
9 e-lavduruarshime shërbesa e Frymësë? Sepse ndë qoftë se shërbesa e dënimit *është* lavdi, shumë më tepërë tepëron ndë lavdit  
10 shërbesa e drejtërisë. Sepse as ulavduruua nga këjo anë ajo që qe e-lavduruarshime, për punë t'asaj lavdisë që kapërxen çdo  
11 masë. Sepse ndë qoftë se ajo që qe për të prishurë *qe* e-lavduruarshime, shumë më tepër' *është* e-lavduruarshime ajo që mbetetë.

12 Dyke pasurë pra të-këfillë shpresë, fla-  
13 sëmë me shumë kuxim; Edhe jo si Moisiu që vinte mbulesë mbi faqet të ti, që të mos e vështroninë me sy të bijt'e Israilit fundin' e  
14 asaj që ishte për të prishurë. Po mëndjet'e atyre uverbuanë; sepse gjer mbë ditën' e-sormë gjithajo mbulesë mbetetë e-pasbuluarë mbë të-kënduarët të dhjatës' së-vjetërë, e-cila mbu-

15 *lesë* është e-prishurë me anë të Krishtit. Po  
 gjer sot, kur këndonetë Moisiu, mbulesë gjën-  
 16 detë mbi zëmëret t' atyre. Po kur të kthenetë  
 17 *Israilli* te Zoti, dot' i hiqetë mbulesa. Po, Zoti  
 është Fryma; edhe ku është Frym' e Zotit,  
 18 atje është liri. Po neve të-gjithë dyke parë  
 lavdin' e Zotit me faqe të-sbuluarë posi ndë  
 pasqyrë, ndërrojmë formënë mbë gjithatë  
 shëmbëllesë prej lavdie mbë lavdi, posi prej  
 Frymës' së Zotit.

## Krye. 4.

1 Përandaj dyke pasurë këtë shërbesë, si  
 2 kundrë upërdëlllyemë, s' lodhemi; Po mohua-  
 më të-fshehurat' e turpërisë, e s' ecëjmë me  
 dinakëri, as nukë prishmë fjalën' e Perëndisë  
 me kobim, po me të-përçfaqurit' e së-vërte-  
 tësë ndorëzojmë vetëhenë t' ënë mbë çdo ndër-  
 3 gjegje njerëzish përpara Perëndisë. Edhe ndë  
 qoftë se është i-mbuluarë ungjilli ynë, është  
 4 i-mbuluarë mb' ata që humbenë; Sepse Pe-  
 rëndia i kësaj jete verboj mendimet' e aty-  
 reve që s' bësonjënë, që të mos ndrìçonjë  
 mb' ata drita e ungjillit të lavdis' së Krishtit,  
 5 i-cili është shëmbëlles' e Perëndisë. Sepse s'  
 lëçijmë vetëhenë t' ënë, po Zotinë Jisu Krisht;  
 edhe vetëhenë t' ënë, për shërbëtorë mbë ju  
 6 për Krishtinë. Sepse Perëndia që tha të ndrì-  
 çonjë dritë nga errësira, *është* ay që ndrìçoj  
 ndë zëmërat t' ona për të dhënë të-ndriturit'

e të-njohurit të lavdis'së Perëndisë ndë fa-  
 qet të Jisu Krishtit.  
 7 Edhe kemi këtë thesar ndë enë të-bal-  
 tëta, që të jetë tepërica e fuqisë nga Perën-  
 8 dia, edhe jo nga ne; Mbë çdo gjë shtrëngo-  
 nemi, po nukë jemi ndë ngushtësirë; jemi  
 9 të-ngatëruarë, po nukë dëshpëronemi; Ndi-  
 qemi, po nukë jemi të-lënë nga Perëndia;  
 jemi të-hedhurë poshtë, po s'jemi të-hum-  
 10 burë; Kurdo bjemë rreth vdekjen' e (Zotit)  
 Jisu ndë trupt t' ënë, që edhe jeta e Jisujt të  
 11 çpërfaqetë ndë trupt t' ënë. Sepse neve që  
 rrojme gjithënjë epemi mbë vdekje për Kri-  
 shtinë, që të çpërfaqet' edhe jeta e Jisujt ndë  
 12 misht t' ënë të-mortçim. Kaqë sa vdekja puno-  
 13 netë mbë ne, e jeta mbë ju. Edhe dyke pa-  
 surë po atë frymë të besësë, pas të-shkrua-  
 rit, „Besova, përandaj fola,“ edhe neve be-  
 14 sojmë, përandaj edhe flasëmë; Dyke diturë,  
 se ay që ngjalli Zotinë Jisu dotë ngjallnjë  
 edhe neve me anë të Jisujt, edhe dotë na  
 15 nxjerrë përpara ati bashkë me ju. Sepse të-  
 gjitha *janë* për ju, që hiri dyke tepëruarë për  
 të-faluritë ndersë e më të-shumëvet të te-  
 16 përonjë mbë lavdin' e Perëndisë. Përandaj s'  
 lodhemi; po ndonëse njeriu ynë i-përja-  
 shtësm prishetë, i-përbrëndëshmi përsëritetë  
 17 dita me ditë. Sepse shtrëngimi ynë i-lehtë  
 që është për pak kohë punon për ne një të-  
 18 përjetëshme lavdi së-tepërmi të-madhe; Sep-

se neve nukë shtjemë sytë mb'ato që shihenë, po mb'ato që nukë shihenë; sepse ato që shihenë janë për pak kohë, po ato që nukë shihenë janë të-përjetëshme.

#### Krye 5.

- 1 Sepse e dimë, se ndë uprishtë shtëpia jonë e-baltëtë e kësaj tende, kemi një *tjatërë* ndërtesë prej Perëndisë, një shtëpi jo të-bërë me dorë, *po* të-përjetëshme, ndë qiejt.
- 2 Sepse ndë këtë *tendë* neve psherëtimë, dyke dëshëruarë të veshmë përsipërë shtëpinë t' ënë qiellorë; Ndë qoftë se kemi veshurë *atë*,
- 4 nukë dotë gjëndemi të-sveshurë. Sepse *neve* që jemi ndë këtë *tendë*, psherëtimë ndënë barrët t'asaj; sepse s'duamë të svishemi, po të vishemi përsipërë, që të përpihetë e-morçimja prej jetësë. Edhe ay që na bëri për këtë punë, *është* Perëndia, i-cili edhe na dha
- 6 kaparin' e Frymësë. Dyke pasurë pra zëmërë përherë, edhe dyke diturë, se gjersa rrimë
- 7 ndë trupt jemi lark nga Zoti; (Sepse ecëjmë
- 8 me besë, e jo me faqe;) Përandaj kemi zëmërë e na pëlqen me tepërë të jemi lark
- 9 nga trupi, e të jemi përanë Zotit. Përandaj edhe përpiqemi, a dyke qënë afërë, a dyke qënë lark, të jemi të-pëlqyerë tek ay.
- 10 Sepse të-gjithë ne duhetë të dukemi përpara gjykatores' së Krishtit, që të çpaguhetë gjithë-sicili për ato *punëra që janë punuarë*

me anë të trupit, sipas atyreve që bëri, a të-mirë, a të-ligë.

- 11 Dyke diturë pra frikën'e Zotit, njerësvet u'a mbushmë mëndjenë, edhe të Perëndia jemi të-çfaqurë; edhe shprenj se edhe ndë
- 12 ndërgjegjet t'uaj jemi të-çfaqurë. Sepse nukë ndorëzojmë vetëhenë t'ënë përsëri te ju, po u apëmë juve ngajë të mburreni për neve, që të keni *ç'tu thoni* atyreve që mburrenë me faqe,
- 13 e jo me zëmërë. Sepse ose jemi jashtë mënc, për Perëndinë *jemi*, ose jemi ndër mëntt,
- 14 për ju *jemi*. Sepse dashuria e Krishtit na shtrëngon; sepse kështu gjykojmë, se ndë
- 15 vdiq një për të-gjithë, të-gjithë pa fjalë vdiq-në; Edhe vdiq për të-gjithë, që të mos rronjënë më për vetëhen' e tyre ata që rronjënë,
- 16 po për atë që vdiq e ungjall për ata. Përandaj neve që ndashti e paskëtaj s'njohëmë asndonjë pas mishit; edhe ndonëse e njohmë
- 17 Krishtinë pas mishit, po ndashti më s'e njohëmë. Përandaj ndë është ndonjë mbë Krishtinë, *ky është* ndërtes'e-re; të-vjetëratë shkutinë, ja të-gjitha tek ubënë të-ra. Edhe të-gjitha janë prej Perëndisë, që na paqtoj me
- 18 vetëhen' e ti me anë të Jisu Krishtit, edhe na dha shërbesën'e të-paqtuarit; Do-me-thënë Perëndia ishte mbë Krishtinë, dyke paqtuarë botënë me vetëhen' e ti, pa numëruarë atyre fajet'e atyre; edhe vuri ndër ne *për shërbësë* fjalën'e të-paqtuarit.

- 20 Për Krishtinë pra lajmësojmë, sikurse t'u lutej Perëndia me anë t'ënë; u lutemi pra juve për Krishtinë, paqtohi me Perëndinë.
- 21 Sepse *Perëndia* atë që s'njohu faj për ne e bëri *të jetë* faj, që të bënemi neve drejtëria e Perëndisë me anë t'ati.

## Krye 6.

- 1 Edhe si punëtorë bashkë me atë, u lute mi juve të mos e pritni hirin'e Perëndisë
- 2 mbë të-kotë; (Sepse thotë, „Ndë kohë të-pëlqyerë të dëgjova ty, edhe ndë ditë shpëtimi të ndiha ty;“ ja ndashti *tek është* koh'e-pëlqyerë; ja ndashti *tek është* ditë shpëtimi;)
- 3 Mbë asndonjë gjë s'apëmë asndonjë pengësë, që të mos shahetë shërbesa jonë; Po mbë çdo gjë ndorëzojmë vetëhenë t'ënë si shërbëtorë të Perëndisë, ndë shumë durim, ndë shtrëngime, ndë nevojë, ndë ngushtime,
- 5 Ndë të-rrahura, ndë burgje, ndë trumbullimë, ndë mundime, ndë të-paflejtura, ndë agjërime; Ndë pastrim, ndë urtësi, ndë zëmërrë të-gjerë, ndë mirësi, ndë Frymë të-Shënjtëruarë, ndë dashuri pa dy faqe; Ndë fjalë të së-vërtetësë, ndë fuqi të Perëndisë; me armët'e drejtërisë ndë dorët të-djathtë e ndë të-mëngjërët; Ndë lavdi e *ndë* çnderim, ndë emërë të-mirë e *ndë* emërë të-keq; posi gënjeshhtarë, po të-vërtetë; Posi të-panjohurë, po të-njohurë mirë; po si *njerës* që vdesënë,

- po ja tek rrojmë; posi të-munduarë, po jo 10 të-vdekurë; Posi të-hidhëruarë, po gjithënjë të-gëzuarë; posi të-vobeq, po shumë veta i bëjmë të-pasurë; possi *njerës* që s'kanë gjë, po të-gjitha i kemi ndë dorë.
- 11 Goja jonë uhap mbë ju, o Korinthianë, zë- 12 mëra jonë usgjerua. Nukë jeni ndë ngushtim mbë ne, po jeni ndë ngushtim përbrënda
- 13 jush. *Dyke çpaguarë* pra *neve* gjithatë çpaggim, (posi bijve u flas,) sgjerohuni edhe ju.
- 14 Mos hyni mbë një sgjedhë me të-pabesëtë; sepse ç'pjesë ka drejtëria me panominë? 15 edhe ç' shoqëri *ka* drita me errësirënë? Edhe ç'të-bashkuarë *ka* Krishti me Velialinë? a 16 ç' pjesë *ka* besëtari me të-pabesinë? A ç' bashkim ka tempulli i Perëndisë me idhujtë? sepse ju jeni tempulli i Perëndisë' së-gjallë, sikundër tha Perëndia, „Se dotë rri brënda 17 im.“ Përandaj „diloni nga mezi i atyreve, edhe ndahi *nga ata*,“ thotë Zoti, „edhe mos ziri me dorë gjë të-pëgërë;“ edhe „unë dot' 18 u pres juve përbrënda, Edhe dotë jem Ati juaj, edhe ju dotë jeni bijt' e mi edhe bijat' e mija, „thotë Zoti Gjithë-pustetësi.

## Krye 7.

- 1 Dyke pasurë pra, o të-dashurë, këto të-zotuarë, letë qërojmë vetëhenë t'ënë nga ç'do

ndyrësirë të mishit e të shpirtit, dyke punuarë shënjtëri me frikë Perëndie.

- 2 Ep-na-ni neve vënt *ndër ju*; asnjëri s' i bëmë keq; asnjëri nukë prishmë *ndë karaktirt*,  
 3 asnjëri s' i muarmë gjë tepërë. Nuk' e them *këtë* për të dënuarë juve; sepse u thashë juvë që përpara, se jeni ndë zëmërat t'ona, kaqë sa të vdesmë bashkë e të rrojmë bashkë.  
 4 Shumë kuxim kam mbë ju, shumë të-mburrurë kam për ju; jam plot me ngushullim, kam gëzim të-math me të-tepërë mbë gjithë shrtëngimnë t'ënë.  
 5 Sepse si erthmë ndë Maqedhoni, trupi ynë s'pat asndonjë të-prëjturë, po gjëndeshimë ndë shtrëngime mbë çdo gjë; përjashta luf-  
 6 tëra, përbrënda frikëra. Po Perëndia që ngushullon të-përunjuritë, na ngushulloj me të-ardhurit'e Titosë; Edhe jo vetëmë me të-ardhurit'e ati, po edhe me ngushullimnë që un-  
 7 gusullua ndër ju, dyke dëftyerë neve mallinë t' uaj të-math, të-qarëtë t' uaj, zëmërenë t' uaj të-përvëluarë për mua; kaqë sa ugëzova  
 8 më tepërë. Sepse, ndonëse u hidhërova juve me kartënë, s'pendonem, ndonëse pendoneshe; sepse shoh se ajo kartë, ndonëse për  
 9 pak kohë, u hidhëroj juve. Ndashti gëzonem, jo se uhidhëruatë, po se uhidhëruatë për pendim; sepse uhidhëruatë si pas *udhës' së* Perëndisë, që të mos u bënë të juve ndonjë  
 10 dëm prej nesh. Sepse hidhërimi sipas *udhës'*

- së Perëndisë bje pendim për shpëtim, për të-cilinë s' pendonetë njeriu; po hidhërimi i bo-  
 11 tësë bje vdekje. Sepse ja gjithajo punë, të-hidhëruarëtë t' uaj sipas *udhës' së* Perëndisë, sa kujdes solli mbë ju! po *sa* fjalë për të-drejttëruarë, po *sa* zëmëratë, po *sa* frikë, po *sa* mall, po *sa* zëmërrë të-përvëluarë, po *sa* çpagim! me të-gjitha e dëftyetë vetëhenë t' uaj  
 12 se jeni të-qëruarë mbë *këtë* punë. Përandaj, ndonëse u shkrova juve, nuk' e bëra *këtë* për atë që bëri paudhëri, as për atë që i ubë paudhëri, po që të trëgonetë mbë ju kujdesi ynë që këmi për ju përpara Perëndisë.  
 13 Përandaj unguhalluamë për ngusullimnë t' uaj; edhe shumë më tepërë ugëzuamë për gëzimn' e Titose se i uprëjt shpirti prej juve  
 14 të-gjithëve. Sepse ndë umburra mbë gjë tek ay për ju, s' uturpëruashë; po sikundrë u folmë juve për të-gjitha me të-vërtetë, kështu edhe të-mburruritë t'ënë të Titua *për ju* doli  
 15 të-vërtetë; Edhe atij i shtonetë më tepërë dashuria për ju, kur bje ndër mëntt të-bin-durit' e juve të-gjithëve, se qysh me frikë e me të-dridhurë e prittë atë.  
 16 Gëzonem pra se mbë çdo *punë* kam kuxim mbë ju.

#### Krye 8.

- 1 Edhe u bëjmë juve të dini, o vëllezër, hirin' e Perëndisë që është dhënë mbë kishërat

2 të Maqedhonisë; Se tepërica e gëzimit t'atyre, ndonëse ishinë ndë shumë provim shtrëngimi, edhe vobëzia e atyre e-thellë e treguanë me të-tepërë pasjen' e dorës's'atyre së-liruarë. Sepse pas fuqis' së tyre, (e dëshmonj këtë,) edhe përmbi fuqin' e tyre *dhanë* dyke 4 dashurë vetë; më shumë të lutura na ulutnë neve t'a presëmë dhuratën e pjesën' e tyre 5 ndë shërbesët që është për shënjtorët. Edhe këtë *bënë*, jo sikundrë shpryemë, po dhanë vetëhen'e tyre më përpara te Zotit, *pastaj* edhe 6 te ne me dashurim të Perëndisë; Kaqë sa i ulutëm Titosë, sikundrë e pat zënë përpara, kështu edhe t'e mbaronjë mbë ju edhe këtë hir. 7 Po sikundrë tepëroni mbë çdo gjë, ndë besë e ndë fjalë e ndë dituri e ndë çdo kujdes, e ndë dashurit t'uaj mbë neve, *kështu* të 8 tepëroni edhe ndë këtë hir. Nuk'e them këtë me urdhër, po që me anë të kujdesit të të-tjerëvet të provonj edhe të-thjeshtët' e dashurisë s'uaj; Sepse dini hirin' e Zotit t'ënë Jisu Krisht, se, ndonëse ishte i-pasurë, ubë i-vobek për ju, që të bëhi ju të-pasurë me 10 anë të vobëzis' s'ati. Edhe mbë këtë u ap këshillë; sepse këjo është e-mirë për ju, të-cilëtë zutë që vjet jo vetëmë t'a bëni, po 11 edhe t'a kërkoni. Ndashti pra mbaro-e-ni edhe të-bërëtë, që, sikundrë *qe* dëshira për të kërkuarë, kështu të jetë edhe për të mbarua-12 rëtë nga ato qe kini. Sepse ndë është gati

zëmëra te ndonjë që përpara, ky është i-piturë me të-mirë pas atyreve që ka, e jo 13 pas atyreve që s'ka. Sepse nukë dua të-tjerë të *kenë* të-prëjturë, e ju shtrëngim; Po të *bënetë* me mbarasim, që mbë këtë kohë tepërica juaj të *mbushnjë* të-shterët'e atyreve, që edhe tepërica e atyreve të mbushnjë të-shterëtë t'uaj *mbë ndonjë kohë*; që kështu të 15 bënetë mbarasim, Sikundrë është shkruarë, „Ay që *mbloodhi* shumë, nukë mori më shumë, edhe ay që *mbloodhi* pak, nukë mori më pak. 16 Po falemi ndersë Perëndisë që ep ndë 17 zëmëret të Titosë gjithatë kujdes për ju; Sepse priti të-luturitë t' *ënë*; edhe dyke qënë i-kujdesurë më tepërë, dolli me dashuri të ti 18 që të vinjë te ju. Edhe bashkë me atë dërguam' atë vëllanë, lëvdim' i të-cilit për ungjil-19 llinë *është* ndëpër të-gjithë kishët; (Edhe jo vetëmë *këjo*, po edhe usgjoth prej kishëvet që të jetë shoku ynë ndë udhët me këtë dhuratë, që punonetë prej nesh për lavdin' e Zotit vetë, edhe *për të dëftyerë* zëmërenë t'uaj të-20 gatishime;) Dyke druajturë nga këjo, se mos na shanjë ndonjë për këtë *ndihmë* të-tepërë 21 që punonetë prej nesh; Sepse kujdesemi për *punëra* të-mira jo vetëmë përpara Zotit, po 22 edhe përpara njerësvet. Edhe dërguamë bashkë me ata vëllanë t' *ënë*, të-cilinë e kemi provuarë shumë herë mbë shumë punëra se është i-kujdesurë, po ndashti është shumë më i-kuj-

23 desurë për besimn' e-math që ka mbë ju. Sa për Titonë, *ay është* shoku im edhe mbë ju bashkëpunëtuar; edhe sa për vëllezëritë t' anë, *këta janë* apostoj të kishëvet, lavdi e Krish-tit. Dëfteni pra mb'ata, edhe përpara kishëvet, dëftesën' e dashurisë s' uaj, edhe të tëmburrurit t' ënë për ju.

#### Krye 9.

1 Sa për shërbesënë që bënetë për shënjtorëtë është e-tepërë për mua t'u shkruanj  
2 juve. Sepse e di zëmërenë t' uaj të-gatishime, për të-cilënë mburrem për ju te Maqedho-nasitë, se Ahaia ubë gati që vjet; edhe për-vëllimi i zëmëresë s' uaj ndezi më të-shumëtë  
3 veta. Edhe dërgova vëllezëritë, që sa për këtë gjë të mos dalë të-kotë të-mburruritë t' ënë për ju, qe, (sikundrë thoshnjam,) të  
4 jeni bërë gati; Semos, ndë arçinë bashkë me mua Maqedhonas, e u gjenjënë juve të-pabërë gati, turpuronemi neve (që të mos themi ju,)  
5 për këtë qëndrim të të-mburrurit t' ënë. Për-andaj umenduashë *se është* nevojë t' u lutem vëllezërvet që të vinjënë më përpara te ju, e të bënjënë gati këtë eleimoniunë t' uaj që uzotuatë që përpara, që kështu të jetë këjo gati si eleimosinë, e jo si lakmim.  
6 Edhe këtë *e them*, se ay që mbjell me kursim, edhe me kursim dotë korrnjë; edhe ay që mbjell me dorë të-hapëtë, edhe me

7 dorë të-hapëtë dotë korrnjë. Gjithë-sicili *letë apë* sikundrë t'i dojë zëmëra, jo me hidhërim, a prej nevoje; sepse Perëndia do atë që ep  
8 me zëmëre të-gëzuarë. Edhe Perëndia është i-fortë të tepëronjë çdo hir mbë ju, kaqë sa passi të kini gjithënjë mbë çdo *gjë* gjithë sa duhenë, të kini të-tepëra për çdo punë të-mirë;  
9 (Sikundrë është shkruarë, „Përndau, u dha të-vobeqvej; drejtëria e ati mbetetë për jetën'  
10 *e jetësë.*“ Edhe ay që i ep farë ati që mbjell, edhe bukë për të ngrënë, dhëntë e shumcftë farënë t' uaj, e rritte pemët' e drejtërisë s' uaj;)  
11 *E* të bëhi të-pasurë nga të-gjitha mbë çdo *punë që kërkon* dorë të-hapëtë, e-cila gjë punon me anë t' ënë të-falurë ndersë mbë Pe-  
12 rëndinë. Sepse puna e kësaj shërbese jo vetëmë mbush me të-plotë të-shterat' e shënjtorëvet, po edhe tepëron me shumë të-falura  
13 ndersë mbë Perëndinë, (Sepse dyke provuarë këtë shërbesë, *ata* lavduronjënë Perëndinë për të-binduritë që rrëfeni mbë ungjillin' e Krishtit, edhe për dorënë t' uaj të-hapëtë që  
14 u ndih atyre edhe gjithëve,) Edhe me të-luturit' e atyre për ju, sepse kanë shumë mall për ju, për të-tepërinë hir të Perëndisë mbë ju.  
15 *Qoftë* të-falurë ndersë mbë Perëndinë për dhurëtin' e ati që s'tregonetë *me gojë*.

#### Krye 10.

1 Edhe unë vetë Pavli u lutem juve me

anë të butësirës' e të ëmblësirës'së Krishtit, unë i-cili faqe për faqe jam i-përunjurë ndë mest t'uaj, e për-së-largu kam kuxim mbë 2 ju; Edhe u lutem, që, kur të vinj, të mos marr kuxim me atë besimnë, me të-cilinë mendonj të kuxonj kundrë disave, të-cilëtë na numëronjënë se sikur ecëjmë pas mishit; 3 Sepse, ndonëse ecëjmë ndë mishit, nukë bëj- 4 më luftë pas mishit. Sepse armëi'e luftësë s'onë nukë janë të-mishta, po të-fora me 5 Perëndinë për të rrëzuarë fortesa; Sepse rrë- zojmë mendime edhe çdo lartësirë qe ngri- hetë lart kundrë të-njohurit të Perëndisë, edhe bëjmë rop çdo mendim që t'i bindetë 6 Krishtit; Edhe jemi gati të marrëmë çpagim për çdo pabindje, kur të bënetë të-plotë të- binduritë t'uaj.

7 A shihni ato që dukenë për faqe? Ndë ka ndonjë të-besuarë mbë vetëhen' e ti se është i Krishtit, let'a mendonjë këtë përsëri prej vetëhes' së ti, se, sikundrë ay është i Krishtit, kështu edhe neve jemi të Krishtit.

8 Sepse, edhe ndë uburrça ca më tepërë për pushtetinë t'ënë, që na dha Zoti për ndër- tim, e jo për të-rrëzuarëtë t'uaj, nukë dotë 9 turpëronem; Qe të mos dukem, se dua t'u 10 frikësonj juve me anë të kartëravet. Sepse, thotë ndonjë, kartëratë janë të-rënda edhe të- forta; po të-qënurit'e ati këtu me trup ështëë 11 të-dobëtë, edhe fjala e ati s'vëjen gjë. I-kë-

tilli letë dijë këtë, se të-çfarëtë jemi ndë fja- lët me kartëra, kur jemi lark, t'atillë jemi 12 edhe mbë punët kur jemi afërë. Sepse nukë kuxojmë të numërojmë a të mbarasojmë ve- tëhenë t'ënë me disa veta nga ata që ndorë- zojnë vetëhen'e tyre; po ata vetë dyke maturë vetëhen' e tyre me vetëhen' e tyre, edhe dyke mbarasuarë vetëhen' e tyre me vetëhen' e tyre 13 s'kupëtonjënë. Po neve nukë dotë mburremi jashtë masësë, po pas masës' së rregullësë qe ndau Perëndia mbë ne, masë, sa të arrij- 14 më edhe gjer ndër ju; Sepse s'e shtrijmë te- përë vetëhenë t'ënë, sikurse nukë arritmë ndër ju; sepse edhe gjer te ju arritmë me 15 anë të ungjillit të Krishtit. Edhe nukë mbur- remi jashtë masësë për mundime të-huaj, po kemi shpresë, se, dyke ushtuarë besa ju- aj, dotë madhonemi mbë ju për-së-tepëri, 16 pas rregullësë s'onë, Kaqë sa të lëçijmë un- gjillinë edhe mb'ata vënde që janë tej jush, që të mos mburremi për ato që janë gati 17 ndë rregullë të-huaj. Po ay që mburretë, mbë 18 Zotinë letë mburretë; Sepse s'është-i-provuarë ay që ndorëzon vetëhen'e ti, po ay të-cilin' e ndorëzon Zoti.

## Krye. 11.

1 Makar të duroni pakëzë marrësinë t'ime; 2 po edhe më duroni. Sepse u kam zili juve me zili Perëndie; sepse u vlova juve me një

burrë, që t'u nxjer përpara Krishtit *si* vër-  
 3 gjëreshë të-pastrëtë. Po kam frikë, se mos  
 sikundrë gjarpëri gënjeu Evënë me dinakë-  
 rin'e ti, prishetë kështu *edhe* mëndja juaj  
 4 *dyke rënë* nga thjeshtësira që është mbë  
 Krishtinë. Sepse ndë arthtë ndonjë e t'u lë-  
 çitnjë një tjetërë Krisht, që nuk' e kemi lë-  
 çiturë, a merrni *një* tjetërë frymë, qe s'e keni  
 marrë, a *një* tjetërë ungjill, që s'e keni pri-  
 turë, me të-mirë dot'e duronit' atë.

5 Po pandeh, se as mbë ndonjë punë s'kam  
 mbeturë prapa *edhe* nga më të-shënuarëtë  
 6 apostoj. Edhe ndonëse jam njeri i-trashë  
 mbë fjalët, po jo *edhe* nga dituria; po me  
 çdo mënyrë uçpërfaqmë mbë të-gjitha ndër  
 7 ju. Apo bëra faj, dyke unjurë vetëhenë t'ime,  
 që të larttoni ju, sepse dhurëti u lëçita juve  
 8 ungjillin'e Perëndisë? Të-tjera kishë i ropa,  
 dyke marrë të-nevojshimetë *prej atyreve* për  
 9 të shërbyerë juve. Edhe kur ishnjam ndër  
 ju e pata të-shterë, s'i ubëra barrë asndo-  
 njëj; sepse të-shterëtë t'im e mbushnë vë-  
 llezëritë që erthnë nga Maqedhonia; edhe  
 mbë çdo punë uruajçe, edhe dotë ruhem, që  
 10 të mos bënem barrë mbë ju. E-vërteta e  
 Krishtit është tek unë, se nukë dotë me  
 mbylletë *goja për* këta të mburrurë ndë vën-  
 11 det të Ahaise. Përse? sepse s'u dua juve?  
 12 Perëndia e di. Po atë që bënj, edhe *gjithënjë*  
 dot'a bënj, që të pres shkakun' e atyreve që

duanë shkak, që mb'atë *punë* që mburrenë  
 të gjëndenë të-tillë si edhe neve.

13 Sepse të-tillëtë *njerës janë* apostoj të-rrem,  
 punëtorë kobimtarë, dyke ndërruarë formënë  
 14 mbë apostoj të Krishtit. Edhe s' është për  
 të çuditurë; sepse vetë Satanaj ndërron for-  
 15 mënë mbë ëngjëll drite. S' është pra *pun'* e  
 madhe, ndë edhe punëtorët' e ati ndërronjënë  
 formënë mbë punëtorë drejtërie; e-pastajm' e  
 të-cilëvet dotë jetë sipas punëvet t' atyre.

16 Përsëri them, Asndonjë letë mos më pan-  
 dehnyë se jam i-marrë; ndë mos, pak-së-paku  
 prit-më-ni si të-marrë, që të mburrem edhe  
 17 unë pakëzë. Atë që flas mbë këtë kuxim *t'im*  
 për të mburrurë, nuk' e flas sipas Zotit, po  
 18 si ndë marrësi e *sipërë*. Me-qënë-që shumë  
*veta* mburrenë pas mishit, dotë mburrem edhe  
 19 unë. Sepse dyke qënë *ju* të-urtë, me ëmbëlsirë  
 20 duroni të-marrëtë; Sepse duroni, ndë u bëftë  
 juve ndonjë robër, ndë *u* hëngërtë ndonjë,  
 ndë *u* marrtë ndonjë *t' uajatë*, ndë umbajtë  
 ndonjë mbë të-math, ndë u rrahtë ndonjë  
 21 juve ndë faqet. Për turp e them këtë, sikurse  
 neve ishimë të-dobëtë; po mbë çdo gjë që ku-  
 xon ndonjë, (si i-marrë po kuvëndonj,) kuxonj  
 22 edhe unë. Evrej janë? edhe unë; Israilitë janë?  
 edhe unë; far' e Avramit janë? edhe unë;  
 23 Shërbëtorë të Krishtit janë? (*si* jashtë mënc  
 flas,) më tepërë unë; mbë mundime më te-  
 përrë, mbe plagë jashtë masësë, ndë burgje

24 më tepërë, ndë vdekje shumë herë. Prej Judhenjvet pesë herë mora dy-zet *frushkulla*

25 pa një; Tri herë urrehçë me shkop, një herë ugodicë me gurë, tri herë umbyçë ndë det, një nat' e një ditë kam bërë ndë funtt *të detit*; Ndë udhëtime shumë herë, ndë rrëzike lumënjsh, ndë rrëzike kursarësh, ndë rrëzike prej farësë *s' ime*, ndë rrëzike prej kombesh, ndë rrëzike ndë qytet, ndë rrëzike ndë shkretëtirë, ndë rrëzike ndë det, ndë rrëzike ndër vëllezër të-rrem; Ndë mundim e ndë të-vuarë, ndë të-paflejtura shumë herë, ndë uri e ndë et, ndë agjërime shumë herë, ndë të-ftohëtë e ndë të-sveshurë; Përveç të-përjashtësmevet, puna ime e-përdiçime, kujdesi

29 i kishëvet. Kush është i-dobëtë, e *unë* s'jam i-dobëtë? kush skandalisetë, e *unë* s'digjem?

30 Ndë gjan të mburrem, dotë mburrem për ato *punëra* që kanë të bëjnë me dobësirënë

31 t'ime. Perëndia edhe Ati i Zotit t'ënë Jisu Krisht, i-cili është i-bekuarë ndë jetët *të jetëvet*, e di se nukë gënenj. Ndë Dhamaskë i-par'i kombit *i-vënë prej mbretit Aretë* ruante rrotullë qytetin' e Dhamasqinevet, sepse

33 donte të më zinte; Edhe nga një dritare prej murit usbriçë me një çportë, edhe shpëtova nga duart' e ati.

### Krye 12.

1 Të mburrem me të-vërtetë s'më bën mirë;

sepse dotë vinj ndë të-para e ndë sbulesa të Zotit.

2 Di një njeri mbë Krishtinë përpara katërmbë-dhjetë vjeç, (a se me trup, s'e di; a se jashtë trupit, s'e di; Perëndia e di;), se i-tilli *njeri* urrembye gjer mbë të-tretinë qiell.

3 Edhe e di të-tillinë njeri, (a se me trup, a

4 se jashtë trupit, s'e di; Perëndia e di;) S'urrembye ndë paradhish, edhe dëgjoj fjalë të-pafolura *me gojë*, të-cilatë s'i ndjenetë njeriut t'i flasë.

5 Për të tiilinë *njeri* dotë mburrem; po për vetëhenë t'ime nukë dotë mburrem, veç për

6 dobësirat' e mia. Sepse ndë daça të mburrem, nukë dotë jem i-marrë; sepse të-vërterënë dotë them; po ndruanj, semos pandehnjë ndonjë për mua më tepërë nga ajo që më sheh, a më tepërë nga ajo që dëgjon prej meje.

7 Edhe që të mos mbahem mbë të-math për sbulesat'e-tepëra, m'udha një gjëmp ndë trupt, ëngjëll Satan, që të më bjerë me shuplaka, që

8 të mos mbahem mbë të-math. Për këtë tri herë i uluçë Zotit, që të mërgonetë prej meje;

9 Edhe më tha, Mjaft të është hiri im; sepse fuqia ime ndë dobësirë tregonet' e-mbaruarë. Me gëzim të-math pra dotë mburrem më tepërë për dobësirat' e mia, që të rrijë tek unë

10 fuqia e Krishtit. Përandaj gjenj pëlqim ndë dobësira, ndë të-shara, ndë nevoja, ndë të-

- ndjekura, ndë shtrëngime, për Krishtinë; sepse, kur jam i-dobëtë, atëhere jam i-fuqishim.
- 11 Ubësh' i-marrë (dyke mburrurë); ju më shtrënguatë; sepse duhej unë të dorëzoeshe prej jush; sepse as mbë një gë s' mbeta prapa nga me të-shënuarët' apostoj, ndonëse
- 12 s'jam gjë. Shënjat' e apostollit upunuanë ndër ju me ç'do durim, me çudira, e me shënja, e
- 13 me fuqira. Sepse mbë ç'punë mbettë prapa nga kishët' e-tjera, përveç se unë vetë nuk' ubëshë barrë mbë ju? fal-m'a-ni këtë paudhëri.
- 14 Ja e-treta herë që jam gati për të ardhurë te ju, e nukë dua t'u bënem barrë; sepse s'kërkoni t'uajatë, po juve; sepse bijtë s'kanë detyrë të mblethnjënë për prindëritë,
- 15 po prindëritë për bijtë. Po unë me gëzim të-math dotë prish edhe dotë prishem fare për shpirtëratë t'uaj, ndonëse, me-gjithë-që u dua
- 16 më tepërë, duhem më pak. Po letë jetë *kështu*, unë nuk' ubëshë barrë mbë ju; po dyke qënë
- 17 dinak, u zura juve me kobim. Mos lakmova gjë prej jush me anë të ndonjëj nga ata që
- 18 dërgova te ju? I uluçë Titosë, edhe bashkë me atë dërgova vëllanë; mos lakmuj gjë prej jush Titua? nuk' ecmë me gjithatë frymë? nuk' ecmë mbë gjithato gjurmë?
- 19 Përsëri pandehni se drejtëronemi përpara jush? flasëmë përpara Perëndisë mbë Krishtinë; edhe të-gjitha këto, o vëllezër, *i bëjmë*

- 20 për të-ndërtuaritë t'uaj. Sepse kam frikë, semos, kur të vinj, nuk' u gjenj juve asish që dua, edhe unë nukë gjëndem te ju i-atillë që doni; *kam frikë*, semos janë *ndër ju* qarta, zilira, zëmërata, të-zëna, të-përfolura, pishtëllime,
- 21 të-mbajtura mbë të-math, trazime; Semos, kur të vinj përsëri te ju, me përunjë Perëndia im, edhe bënj vajë për shumë nga ata që kanë fëjyerë që përpara, edhe s'janë pënduarë për pëgërsirën' e për kurvërin' e për ndyrësirënë që punuanë.

## Krye 13.

- 1 Këjo *është* e-treta herë që vinj te ju „Mbë goje dy e tre dëshimtarëve dotë qëndronë një çdo fjalë.“ Thashë më përpara, edhe po them më përpara, sikurse jam aty të-dytënë herë, edhe ndashti që jam lark u shkruanj atyreve që kanë fëjyerë që përpara edhe gjithë të-tjerëvet, se, ndë arthça përsëri, nukë dotë
- 3 kursenem; Sepse kërkoni provë të Krishtit që flet me anë t'ime, i-cili s'është' i-dobëtë mbë
- 4 ju, po i-fuqishim ndër ju. Sepse, ndonëse ukryqëzua prej dobësire, po rron prej fuqis' së Perëndisë; sepse edhe neve ndonëse jemi të-dobëtë mbë atë, po dotë rrojmë bashkë me
- 5 atë mbë ju prej fuqis' së Perëndisë. Shikoni vetëhenë t'uaj; ndë jeni ndë besët; provoni vetëhenë t'uaj; apo s'e njihni vetëhenë t'uaj, se Jisu Krishti është ndër ju? veç ndë qofshi

- 6 të-paprovuarë mbë ndonjë gjë. Edhe shpërenj se dot'a njihni se neve s' jemi të-paprovuarë.
- 7 Edhe i lutem Perëndisë që të mos bëni ndonjë gjë të-ligë; jo që të dukemi ne të-provuarë, po që të bëni ju të-mirënë, e neve letë jemi të-paprovuarë. Sepse s' mundimë të bëjmë gjë
- 8 kundrë së-vërtetësë, po për të vërtetënë. Sepse gëzonemi, kur neve jemi të-dobëtë, e ju jeni të-fuqishim; për këtë edhe lutemi, *do-methënë* për të-ndrequritë t'uaj. Përandaj shkruanj këto, kur jam lark, që të mos sillem ashpërë, kur të jem afërë, sipas pushtetit që më ka dhënë Zoti për të ndërtuarë, e jo për të prishurë.
- 11 Pra, o vëllezër, gëzohuni, ngushullohuni, jini mbë gjithatë mëndje, kini paqtim; edhe Perëndia i dashurisë edhe i paqtimit dotë
- 12 jetë bashkë me ju. Përshëndetni njëri tjetërinë me të-puthurë të-shënjtëruarë; u falenë juve me shëndet gjithë shënjtoretë.
- 13 Hiri i Zotit Jisu Krisht, edhe dashuria e Perëndisë, edhe shoqëria e Frymës' së-Shënjtëruarë qoftë me gjithë ju. Amin.

